REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr. 987/20
Data/Datum 16.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.987/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "D&T GROUP" SH.P.K–Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i operatorëve ekonomik: "AM GROUP"SHPK & "CARGOMAX PRISHTINA" SHPK - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Blerja e një automjeti special për zjarrfikësit në Komunën e Prizrenit ", me nr. të prokurimit: 622-3206-1-1-1, inicuar nga AK- "KK-PRIZERN", më datën: 15.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "D&T GROUP" SH.P.K–Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Blerja e një automjeti special për zjarrfikësit në Komunën e Prizrenit ", me nr. të prokurimit: 622-3206-1-1-1, inicuar nga AK- "KK-PRIZERN".

II. **ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Blerja e një automjeti special për zjarrfikësit në Komunën e Prizrenit ", me nr. të prokurimit: 622-3206-1-1-1, inicuar nga AK- "KK-PRIZERN", dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "D&T GROUP" SH.P.K–Gjakovë, aprovohet e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatoret ekonomik ankues "D&T GROUP" SH.P.K–Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.11.2020 me nr. 987/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Blerja e një automjeti special për zjarrfikësit në Komunën e Prizrenit", me nr. të prokurimit: 622-3206-1-1-1, iniciuar nga AK- "KK-PRIZERN", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: neni 1 parag;1 dhe 3, Neni 6 par. 2, Neni 7 par. 1 dhe 4 , Neni 51 , Neni 52 par.4 , Neni 56 , Neni 59 par.2 dhe 4 , Neni 60 par.2 , Neni 69, dhe *Neni* 72 par.3 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 03.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimore ka të bej me : AK ka kërkuar sqarim shtese nga ne një deklarate se a mund të na furnizoni me automjetin "Renault" me specifikat teknike sipas kërkesave te dosjes se tenderit edhe pse ne kemi ofertu me dy opsione ku te dy opsionet e ofertuara nga ne i plotësojnë ne tërësi kërkesat e AK-se sipas dosjes se tenderit, ku ne e kemi te dorëzuar një deklarate për plotësimin e të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara ne dosjen e tenderit konkretisht ne ANEKS 1 të kësaj dosje,kja lind pyetja pse AK nuk e sqaron pse dhe cila nga këto dokumente nuk i përmbushë kriteret e parapara / kërkuara. deklarate është dorëzuar me rastin e dorëzimit te ofertës tone pranë AK ne E-prokurimi, ndërsa e njëjta deklarate na është kërkuar prape edhe njëherë, me sqarim shtese nga AK Komuna e Prizrenit me date 27.10.2020 ku eshte thënë, citoj: "Te na jepni një deklarate me shkrim se do te nafurnizoni (nese shpalleni fitues i kontrates) me automjetin per zjarrefikes te modelit "Renault" sipas katalogut qe e keni derguar me 23.10.2020 me gjitha specifikat e kërkuara ne tender.

Verejtje: AK nuk mban përgjegjësi nëse na furnizoni me automjet qe nuk i ka specifikat e kërkuara ne oferte dhe nuk ja bëjmë pranimin e tyre" mbyllet citati.

Kompania jone menjëherë me date 28.10.2020 ja ka dërguar AK Komuna e Prizrenit nje deklarate sipas kërkesës se tyre (e cila gjindet ne dosjen e lendes), ku kemi deklaruar, citoj: "Me ane te kesaj deklarate kompania jone D & T Group shpk per oferten e saj te dorezuara per tenderin ne fjale deklarojme se kompania jone do ti permbahemi kerkesave te dosjes se tenderit sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne dosjen e tenderit - Modeli Renault do te dorezohet sipas kerkesave te dosjes se tenderit konkretisht sipas specifikimeve teknike".Modeli Renault do te liferohet 90 dite pas nenshkrimit te kontrates(sipas kerkeses se dosjes se tenderit)

Eksperti shqyrtues sqarone se auoriteti kontraktue me datë 27.10.2020 kerkone nga operatori ekonomik ankues te jep deklarate se a mund të na furnizoni me automjetin "Renault" me specifikat teknike sipas kerkesave te dosjes se tenderit., sipas katalogut te ofruar me date 23.09.2020 me të gjitha specifikat e kërkuara në tenderë ankesit 1 të DT-së, me date 28.10.2020 operatorit ekonomik ankues jep deklaratën.

Citoj: Me datën 27/10/2020 ju kemi dërgua një letër standarde me këto kërkesa:Te na jepni një deklerat me shkrim se do te na furnizoni (nëse shpallni fitues i kontratës) me automjetin për zjarrefikës te modelit " Renault " sipas katalogut që e keni dërguar me 23.10 2020 me të gjitha specifikat e kërkuar ne tenderë.

Vërejtje : AK nuk mban përgjegjësi nëse na furnizoni me automjet që nuk i ka specifikat e kërkuara në ofertë dhe nuk ja bëjmë pranimin e automjetit.

Dokumentet e kërkuara duhet të dërgohen (dorëzohen fizikisht në zyrën e prokurimit) ose në e-mail : prokurimipz@hotmail.com ose isa.osmankaj@rks-gov.net deri me 02/11/2020 ora 16 00

Me datën 28/10/2020 na keni dërguar deklaratën me ketë sqarim :Për arsye se automjeti ka një kosto të lartë, në mund ta organizojmë pranim dorëzimin e automjetit special të prodhuesi ynë në Turqi ku do të kontrollohen gjitha specifikimet teknike , një nga një sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe pasi të kemi aprovimin nga personat përgjegjës te KK Prizren ne organizohemi që automjetin ta nisim për Kosovë . të gjitha shpenzimet , si biletat e aeroplanit dhe hotelin për 2 zyrtarë të KK Prizren do ti bartë kompania jonë .

Andaj, operatori ekonomik ankues permese deklarates të kerkuar nga autoriteti kontraktues ka sqaruar automjeti do të jetë konform specifikave të kerkuara në aneksin 1 të dosjes tenderi, po ashtu ka deklaruar se mund të organizoje për dy zyrtare për të pare nga afër prodhimin e automjetit ku do të kontrollohen të gjitha specifikat e kërkuara në Aneksi 1 ku te gjitha shpenzimit do ti barte operatori ekonomik, autoriteti kontraktues lidhur rreth deklarates së ofruar nga operatori ekonomik ankues e eliminon me arsyetimin se nuk kemi pas kesi kerkesa në dosje të tenderit, për të organizuar vizitë në fabrikën ku do të prodhohet kamoni.

Sqaroje se operatori ekonomik ankues në ofertën e tij ka ofruar Deklarate për specifikimet teknike ku deklaron: Ne kompania: D&T-Group sh.p.k Deklarojmë se do ti përmbahemi specifikimeve teknike të detyrueshme për punët e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në aneksin 1 të dosje së tenderit.

Pra autoriteti ka kërkuar prapë deklarate lidhur me specifikimeve teknike të detyrushem, ku operatori ekonomik ankues një deklaratë për specifikimet teknike të detyrushme e ka ofruar në ofertën e tij.
Prandaj autoriteti kontraktues nuk ka respektuar neni 59, Ekzaminimi,Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve, neni 6-LPP-se qe të siguroje fodet publike dhe burime publike të përdoren në menyre me ekonomike, neni 1-Qellimi te LPP-se po ashtu dhe neni 72, LPP-se. Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE **"D&T GROUP" SH.P.K–Gjakovë,**,është e **bazuar**, ndërsa të anulohet njoftimi për dhënje për kontratë, dhe këtë aktivitetit të prokurimit të kthej në **Rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka pergjigje

Operatori Ekonomik, me datën 03.12.2020 me anë te parashtresës ka njoftuar OSHP-në se Pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues .

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "D&T GROUP" SH.P.K–Gjakovë, se AK ka kërkuar sqarim shtesë nga ne një deklaratë se a mund të na furnizoni me automjetin "Renault" me specifikat teknike sipas kërkesave të dosjes së tenderit edhe pse ne kemi ofertu me dy opsione, ku të dy opsionet e ofertuara nga ne i plotësojnë në tërësi kërkesat e AK-së sipas dosjes së tenderit, ku ne e kemi të dorëzuar një deklaratë për plotësimin e të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në dosjen e tenderit konkretisht në ANEKS 1 të kësaj dosje, lind pyetja pse AK nuk e sqaron pse dhe cila nga këto dokumente nuk i përmbushë kriteret e parapara / kërkuara. deklarate është dorëzuar me rastin e dorëzimit te ofertës tone pranë AK ne E-prokurimi, ndërsa e njëjta deklarate na është kërkuar prape edhe njëherë, me sqarim shtese nga AK Komuna e Prizrenit me date 27.10.2020 ku eshte thënë, citoj: "Te na jepni një deklarate me shkrim se do te na furnizoni (nese shpalleni fitues i kontrates) me automjetin per zjarrefikes te modelit "Renault" sipas katalogut qe e keni derguar me 23.10.2020 me gjitha specifikat e kërkuara ne tender.
Verejtje: AK nuk mban përgjegjësi nëse na furnizoni me automjet qe nuk i ka specifikat e kërkuara ne oferte

dhe nuk ja bëjmë pranimin e tyre" mbyllet citati.

Kompania jone menjëherë me date 28.10.2020 ja ka dërguar AK Komuna e Prizrenit nje deklarate sipas kërkesës se tyre (e cila gjindet ne dosjen e lendes), ku kemi deklaruar, citoj: "Me ane te kesaj deklarate kompania jone D & T Group shpk per oferten e saj te dorezuara per tenderin ne fjale deklarojme se kompania jone do ti permbahemi kerkesave te dosjes se tenderit sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne dosjen e tenderit - Modeli Renault do te dorezohet sipas kerkesave te dosjes se tenderit konkretisht sipas specifikimeve teknike".Modeli Renault do te liferohet 90 dite pas nenshkrimit te kontrates(sipas kerkeses se dosjes se tenderit).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me datë 27.10.2020 kërkon nga operatori ekonomik ankues të jep deklaratë se a mund të na furnizoni me automjetin "Renault" me specifikat teknike sipas kerkesave të dosjes së tenderit., sipas katalogut të ofruar me datë 23.09.2020 me të gjitha specifikat e kërkuara në tender, aneksit 1 të dosjes së tenderit, me date 28.10.2020 operatori ekonomik ankues jep deklaratën, ku thotë: me datën 27/10/2020 ju kemi dërguar një letër standarde me këto kërkesa: Te na jepni një deklerat me shkrim se do te na furnizoni (nëse shpallni fitues i kontratës) me automjetin për zjarrefikës te modelit " Renault " sipas katalogut që e keni dërguar me 23.10 2020 me të gjitha specifikat e kërkuar ne tenderë.

Vërejtje : AK nuk mban përgjegjësi nëse na furnizoni me automjet që nuk i ka specifikat e kërkuara në ofertë dhe nuk ja bëjmë pranimin e automjetit.

Dokumentet e kërkuara duhet të dërgohen (dorëzohen fizikisht në zyrën e prokurimit) ose në e-mail : prokurimipz@hotmail.com ose isa.osmankaj@rks-gov.net deri me 02/11/2020 ora 16 00

Me datën 28/10/2020 na keni dërguar deklaratën me ketë sqarim :Për arsye se automjeti ka një kosto të lartë, në mund ta organizojmë pranim dorëzimin e automjetit special të prodhuesi ynë në Turqi ku do të kontrollohen gjitha specifikimet teknike , një nga një sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe pasi të kemi aprovimin nga personat përgjegjës te KK Prizren ne organizohemi që automjetin ta nisim për Kosovë . të gjitha shpenzimet , si biletat e aeroplanit dhe hotelin për 2 zyrtarë të KK Prizren do ti bartë kompania jonë.

Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues përmes deklaratës të kërkuar nga autoriteti kontraktues ka sqaruar se automjeti do të jetë konform specifikave të kërkuara në aneksin 1 të dosjes tenderit. Po ashtu, ka deklaruar se mund të organizoj për dy zyrtare për të parë nga afër prodhimin e automjetit ku do të kontrollohen të gjitha specifikat e kërkuara në Aneksin 1, ku të gjitha shpenzimit do ti bartë operatori ekonomik. Kurse, autoriteti kontraktues lidhur me deklaratën e ofruar nga operatori ekonomik ankues e eliminon me arsyetimin se nuk kemi pas kësi kërkesa në dosje të tenderit për të organizuar vizitë në fabrikën ku do të prodhohet kamoni. Operatori ekonomik ankues në ofertën e tij ka ofruar DeklaratË për specifikimet teknike ku deklaron: Ne kompania: D&T-Group sh.p.k Deklarojmë se do ti përmbahemi specifikimeve teknike të detyrueshme për punët e ofruara të cilat përputhen me ato të

përmendura në aneksin 1 të dosje së tenderit.

Pra, autoriteti ka kërkuar prapë deklarate lidhur me specifikimeve teknike të detyrueshëm, ku operatori ekonomik ankues një deklaratë për specifikimet teknike të detyrueshme e ka ofruar në ofertën e tij. Prandaj, autoriteti kontraktues nuk ka respektuar neni 59, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, neni 6-LPP-së që të siguroj se fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, neni 1 Qëllimi të LPP-së, po ashtu dhe neni 72 i LPP-së.

Paneli Shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë vlerësimin dhe ekzamnimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në kudnërshtim me nenin 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me qëllimin e ligjit të prokurimit sikurse është përcaktuar në nenin 1, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që fondet publike të përdorën në mënyrën me ekonomike. Andaj, obligohet AK që të bëjë rivlerësimin e ofertave në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK-PRIZERN";

1x1 OE "D&T GROUP" SH.P.K–Gjakovë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.